


Kronikë

# Përplasja me armë zjarri mbrëmë në Shkodër, 32-vjeçari dhe pronari i furrës së bukës para ngjarjes sherr me grushte për një vajzë në një lokal! Shpallen në kërkim nga policia

*Mësohet se Ndreu dhe Sala u përplasën fizikisht kanë qenë sëbashku në një lokal afër zonës së ngjarjes, ku janë përplasur fillimisht fizikisht. Më pas Ndreu ka marrë armën dhe ka qëlluar në drejtim të furrës së bukës. Nuk dihen ende motivet e sherrit mes tyre, teksa të dy janë arratisur pas ngjarjes dhe janë shpallur në kërkim nga policia.*

Report Tv siguron videon ekskluzive, momenti kur 32-vjeçari qëllon me breshëri plumbash në drejtim të furrës së bukës



*Armando Ndreu dhe Sadet Sala*

Redaksia
23 Mars, 09:56 | Përditesimi i fundit: 23 Mars, 12:46

Të shtëna me armë zjarri tronditën mbrëmjen e djeshme ***Shkodrën***, por fatmirësisht nuk mbetën persona të lënduar. Armando Ndreu qëlloi me breshëri plumbash në drejtim të furrës së bukës në pronësi të Sadet Salës, i cili po ashtu iu kundërpërgjigj duke e qëlluar me pistoletë. Mësohet se Ndreu dhe Sala u përplasën fizikisht kanë qenë sëbashku në një lokal afër zonës së ngjarjes, ku janë përplasur fillimisht fizikisht.

Më pas Ndreu ka marrë armën dhe ka qëlluar në drejtim të furrës së bukës. Burimeve nga policia bëjnë me dije se shkak i konfliktit midis dy Armando Ndreu dhe Sadet Sala dyshohet të jetë bërë një vajzë.


LEXO EDHE:
**Report Tv mes pelegrinëve të Shna Ndout, udhëtim me tren Shkodër-Laç! Bileta vajtje-ardhje 150 lekë, udhëtarët: Të bëhet çdo ditë, zgjidhje e mirë për popullin**

Report Tv siguroi mbrëmjen e djeshme edhe videon ekskluzive të momentit të ngjarjes, ku shihej Armando Ndreu teksa dilte nga automjeti i tij tip 'Golf' dhe më pas i afrohej furrës së bukës dhe qëllon me breshëri plumbash.

Në momentin kur Ndreu qëllon me breshëri plumbash, në rrugë shihen të kalojnë edhe automjete të tjera, por fatmirësisht nuk ka patur persona të lënduar. Ngjarja nuk është zbardhur ende, ndërsa policia vijon kërkimet për arrestimin e dy të rinjve.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 12:42

**Përplasja me armë zjarri mbrëmë në Shkodër, sherri nisi për një vajzë**

Report Tv mëson përmes burimeve nga policia se shkak i konfliktit midis dy Armando Ndreu dhe Sadet Sala, që degradoi deri në përdorimin e armëve mbrëmjen e djeshme, dyshohet të jetë bërë një vajzë. Sherri mes tyre fillimisht nisi në ambientet e një lokali në afërsi të ngjarjes, dy orë para se Ndreu të marrë kallashnikovin dhe të qëllojë në drejtim të furrës së bukës. Policia e Shkodrës ka kryer disa kontrolle në pika ku dyshohej se mund të fshiheshin dy të shpallurit në kërkim, por deri tani nuk kanë mundur të lokalizohen.

J.SH./Shqiptarja.com

TAG: armando ndreu | sadet sala | te shtena me arme | Shkoder

Komento

## Komente

**Nikolin:** 23/03/2022 18:47

Armando eshte i mbrojtur se paguan % tek shefat e policise. Mbi 20 grabitje dhe shetit diten per diell pa i hi ferr ne kembe. Policia se ngacmon, prokuroria ja mbyll hetimet...per terezi.... deri qe ti hasin sharr ne gozhde e ta hajne ndonje kokerr plumbi. Pastaj do shkruani ju qe ishte kontigjent e keken e vet hangri. Rrofte policia e partise dhe drejtesia e reformuar

Përgjigju

**Shkoder:** 23/03/2022 11:30

Ska pas faj e kan shtrejtu shum buken, 100lek 600gram

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Kriza në PD, pas dorëheqjes së Bashës a duhet të tërhiqet edhe Berisha?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Kronikë


Përplasje me armë zjarri në Shkodër/ Report Tv siguron videon ekskluzive, momenti kur 32-vjeçari qëllon me breshëri plumbash në drejtim të furrës së bukës dhe largohet me vrap
Ergys Kavaja
Sokol Dema
22 Mars, 20:21

Kronikë

Kultivuan 2600 fidanë kanabisi në serë, arrestohen babë e bir në Vaun e Dejës
18 Mars, 19:40

Politikë

Nuk fitoi bashkinë e Shkodrës, Majlinda Angoni rikthehet në postin e Prefektes
18 Mars, 10:36

Politikë

Rama publikon fotot nga Spitalin Rajonal i Shkodrës, ironizon opozitën: Sa mirë që s'u ka rënë rruga për spital, shajnë me të dëgjuar
17 Mars, 18:59

Kronikë

Importonte dhe tregtonte lëngje frutash të skaduara, arrestohet pronari i një biznesi në Shkodër
16 Mars, 16:03

Kronikë

Zjarri 'përpin' magazinën në Shkodër, shkrumbohet gjithçka! VIDEO nga 'lufta' e zjarrfikësve me flakët
14 Mars, 10:55

Kronikë

Ndërtuan pa leje në Shirokë, shpallen në kërkim 3 pronarët në Shkodër, nën hetim edhe 3 punonjës të IKMT-së
13 Mars, 08:50

Sociale

VIDEO/ Rritet nafta, Shkodra rikthen trenin për peligrinazh! Shkodër-Laç çdo të martë, bileta e trenit 150 lekë
12 Mars, 20:26

Kronikë

Shkodranët i drejtohen Malit të Zi për t'u furnizuar me karburant, mbushin bidonat plot me naftë
11 Mars, 09:36

Kronikë

Vau i Dejës, përfituan përmes mashtrimit ndihmë ekonomike, 51 qytetarë dhe administratorja sociale e bashkisë nën hetim
11 Mars, 09:10

Sociale

Rritja e çmimeve, protesta në Kukës e Shkodër: Të rriten pagat, rroga na del vetëm për të blerë bukë e kripë! Në Vlorë bllokojnë rrugën për disa minuta (VIDEO)
10 Mars, 12:58

Kronikë

Atentati në Shkodër/ Del FOTO, kjo është makina që u përdor nga autorët! Anëtari i fisit të Bajrave mori 3 plumba në trup, pista kryesore hakmarrja
10 Mars, 09:37



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje